

Vendim nr. 53 datë 13.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 13.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (I) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: IRVI HYKA

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjit nr. 79/2022, datë 24.11.2022 “Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a. dhe NSHMI Development L.L.C për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit””, shpallur me dekretin nr. 13886, datë 21.12.2022 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 41, 42 dhe 116, shkronja “b”, të Kushtetutës; nenet 70 e në vijim të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”” (MSA); nenet 27 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahim i, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 79/2022, datë 24.11.2022 “Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a. dhe Nshmi Development L.L.C për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”” (*ligji nr. 79/2022*). Ky ligj është shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 13886, datë 21.12.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 173, datë 22.12.2022.

2. Në datën 25.01.2023, kërkuesi Irvi Hyka i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e ligjit nr. 79/2022, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuetit

3. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ligji nr. 79/2022 cenon:
- 3.1. *Të drejtën e pronës publike (mostjetërsimi i pronës publike)*, të garantuar nga neni 11, pika 2, i Kushtetutës, pasi procesi nuk ka transparencë ligjore dhe shkel MSA-në që ka përparësi në hierarkinë e normave ligjore në Republikën e Shqipërisë.
 - 3.2. *Parimin e konkurrencës dhe tregut të lirë*, pasi nuk është hapur asnjë tender ndërkombëtar në lidhje me projektin e marrëveshjes dhe e drejta për këtë marrëveshje nuk është fituar në bazë të ndonjë tenderi publik ndërkombëtar.
 - 3.3. *Sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë*, pasi porti detar i Durrësit është objekt i sigurisë së veçantë.
 - 3.4. *Ekonominë kombëtare*, pasi transformimi në një zonë rezidenciale me port marine dhe jahtesh, pa gjetur një zgjidhje konkrete në lidhje me portin tregtar të Durrësit, do të rrisë kostot e importit dhe eksportit të mallrave, për pasojë edhe kostot e jetesës së shtetasve të Republikës së Shqipërisë dhe personave të tjerë juridikë privatë dhe publikë.

- 3.5. *Parimin e subsidiaritetit*, pasi ligji është miratuar nga Kuvendi pa pëlqimin e banorëve të bashkisë Durrës, Këshillit Bashkiak, ose pa referendum dhe nuk është konsultuar me qytetarët e njësisë administrative nr. 1 të kësaj bashkie, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

4. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

5. Kjo dispozitë kushtetuese është zbërthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (*neni 71*), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (*neni 71/a*). Sipas pikës 2 të nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, nëse përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i tij, të cilat lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave dhe lirive kushtetuese, shterimin e të gjitha mjeteve juridike përkatëse dhe zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit objekt ankimi, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore.

6. Gjykata ka theksuar se kur objekt i ankimit kushtetues individual është një ligj ose një akt normativ, kërkuuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se sipas nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individët bëjnë pjesë në grupin e dytë të subjekteve që ushtrojnë në mënyrë të kufizuar të drejtën për t’iu drejtuar asaj, duke pasur legjitimim kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Kjo dispozitë kushtetuese është detajuar edhe në nenin 49 të ligjit nr. 8577/2000, ku parashikohet se të drejtën për të filluar një kontroll për pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë dhe individët (*pika 3/e*), por ata kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta (*pika 4*). Për të treguar se ka legjitimim, individë, si subjekti iniciues i procesit kushtetues, ka detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet interesit ligjor që ai ka dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, individët janë përfshirë në grupin e subjekteve të kushtëzuara që mund t’i drejtohen Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, por për çështje që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka parashtruar se ai ka lindur dhe është banues në qytetin e Durrësit dhe ligji nr. 79/2022 ka cenuar parimet dhe të drejtat e lidhura me pronën publike dhe tjetërsimin e saj pa konkurrencë, sigurinë kombëtare dhe atë publike të banorëve të njësise administrative në të cilën ai është banor, si dhe bie në kundërshtim me MSA-në.

9. Nisur nga parashtrimet e kërkuesit dhe nga normat e standardet e mësipërme kushtetuese, Kolegji vëren se ai ka paraqitur pretendime me natyrë përgjithësuese dhe nuk ka dhënë argumente për të provuar pasojat negative të ardhura ose të pritshme që i vijnë nga zbatimi i ligjit të kundërshtuar, si dhe nuk ka justifikuar interesin e tij vetjak, të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë lidhur me cenimin e së drejtës së pronës publike, parimet e konkurrencës dhe tregut të lirë, sigurinë dhe ekonominë kombëtare, subsidiaritetin dhe respektimin e MSA-së.

10. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk justifikon interesin e tij në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

11. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.